# AQUATIQ SHPK

## PASQYRAT FINANCIARE

## PER PERIUDHEN NGA DATA E THEMELIMIT 20 JANAR 2017 DERI ME 31 DHJETOR 2017

**PERMBAJTJA** **FAQJA**


| | |
|---|---|
| **PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR** | **3-4** |
| **PASQYRA E PERFORMANCES DHE TE ARDHURAVE TE TJERA GJITHEPERFSHIRESE** | **5** |
| **PASQYRA E FLUKSEVE TE MJETEVE MONETARE** | **6** |
| **PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL NETO** | **7** |
| **SHENIMET SHPJEGUESE** | **8- 17** |

## PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

| **AKTIVET** | **Shenime** | **31 dhjetor 2017** |
| --- | --- | --- |
| **Aktivet afatshkurtra** | | |
| **Aktivet monetare** | 4 | **47,841** |
| *Banka* | | *47,841* |
| *Arka* | | - |
| **Investime** | | - |
| **Te drejta te arketueshme** | | **5,064,448** |
| *Nga njesite ekonomike brenda grupit* | 5 | *4,332,795* |
| *Te tjera* | 6 | *731,653* |
| **Inventaret** | | - |
| **Shpenzime te shtyra** | 7 | **2,250** |
| **Te arketueshme nga te ardhurat e konstatuara** | | - |
| **Totali aktiveve afatshkurtra** | | **5,114,539** |
| **Aktivet afatgjata** | | - |
| **Aktive financiare** | | - |
| **Aktivet materiale** | 8 | **1,493,121** |
| *Impiante dhe makineri* | | *791,611* |
| *Te tjera instalime dhe pajisje* | | *701,510* |
| **Aktivet biologjike** | | - |
| **Aktive jo materiale** | | - |
| **Aktive tatimore te shtyra** | | - |
| **Totali aktiveve afatgjata** | | **1,493,121** |
| **Aktive totale** | | **6,607,660** |

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 8 deri ne 17, te cilat jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

## PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

| **DETYRIMET DHE KAPITALI** | **Shenime** | **31 dhjetor 2017** |
|---|---|---|
| **Detyrime Afatshkurtra:** | | |
| *Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit* | 9 | *4,784,858* |
| *Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore dhe shendetsore* | | *6,696* |
| **Te pagueshme per shpenzime te konstatuara** | | - |
| **Te ardhura te shtyra** | | - |
| **Provizione** | 10 | **15,000** |
| **Totali i detyrimeve afatshkurtra** | | **4,806,554** |
| **Detyrime afatgjata** | | |
| *Titujt e huamarrjes* | 11 | *13,315,000* |
| **Te pagueshme per shpenzime te konstatuara** | | - |
| **Te ardhura te shtyra** | | - |
| **Provizione** | | - |
| **Detyrime tatimore te shtyra** | | - |
| **Totali i detyrimeve afatgjata** | | **13,315,000** |
| **Totali i detyrimeve** | | **18,121,554** |
| **Kapitali dhe rezervat** | | - |
| **Kapitali i nenshkruar** | | - |
| **Primi i lidhur me kapitalin** | | - |
| **Rezerva rivleresimi** | | - |
| **Rezerva te tjera** | | - |
| Fitimi i pashperndare | | - |
| **(Humbja) e vitit** | | (11,513,894) |
| **Totali i kapitalit** | | **(11,513,894)** |
| **Totali i detyrimeve dhe kapitalit** | | **6,607,660** |

Keto pasqyra jane miratuar nga administratori i shoqerise Aquatiq me 30.03.2018.

**Aprovuar nga administratori**
**Endlers Kertusha**

AQUATIQ Sh.p.k
Rr."Elbasanit" Pallati Nº1 poshtë
Fakultetit Gjeologji Miniera
Tiranë 1000, Albania
L71320011G

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 8 deri ne 17, te cilat jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

## PASQYRA E PERFORMANCES DHE TE ARDHURAVE TE TJERA GJITHEPERFSHIRESE

| | Shenime | Nga data e themelimit 20 janar 2017 deri me 31 dhjetor 2017 |
|---|---|---|
| **Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit** | | - |
| **Ndryshimi ne inventarin e produkteve te gatshme dhe prodhimit ne proces** | | - |
| **Puna e kryer nga njesia ekonomike dhe e kapitalizuar** | | - |
| **Te ardhura te tjera te shfrytezimit** | | - |
| **Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme** | | - |
| **Shpenzime te personelit** | | **(74,131)** |
| *Shpenzime te sigurimeve shoqerore dhe shendetsore* | | *(44,372)* |
| *Shpenzime te tjera* | | *(29,759)* |
| **Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale** | | - |
| **Shpenzime konsumi dhe amortizimi** | | - |
| **Shpenzime te tjera shfrytezimi** | 12 | **(11,505,176)** |
| **Te ardhura te tjera** | 13 | **65,413** |
| *Interesa te arketueshem dhe te ardhura te tjera te ngjashme (paraqitur veçmas te ardhurat nga njesite ekonomike brenda grupit)* | | *65,413* |
| **Zhvleresimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare te mbajtura si aktive** | | - |
| **Shpenzime financiare** | | - |
| **Pjesa e fitimit/(humbjes) nga pjesemarrjet** | | - |
| **(Humbja) para tatimit** | 14 | **(11,513,894)** |
| **Shpenzimi i tatimit mbi fitimin** | | - |
| **Humbja e vitit** | | **(11,513,894)** |
| *Te ardhura te tjera gjitheperfshirese per vitin* | | - |
| **Totali i humbjeve gjitheperfshirese per vitin** | | **(11,513,894)** |

Pasqyra e performances duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 8 deri ne 17, te cilat jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

## PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE

| | Shenime | Nga data e themelimit 20 janar 2017 deri me 31 dhjetor 2017 |
|---|---|---|
| **Fluksi i Mjeteve Monetare perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit** | | |
| Humbja e vitit | 14 | (11,513,894) |
| | | |
| Rregullimet per shpenzimet jomonetare: | | |
| *Shpenzimet financiare jomonetare* | 13 | *65,413* |
| *Renie/(rritje) ne te drejtat e arketueshme dhe te tjera* | 5, 6 | *(5,064,448)* |
| *Rritje/(renie) ne detyrimet e pagueshme* | 9 | *4,784,858* |
| *Rritje/(renie) ne detyrime per punonjesit* | | *6,696* |
| *Rritje/(renie) ne te pagueshme per shpenzime te konstatuara* | 7 | *(2,250)* |
| *Rritje/(renie) ne provizione* | 10 | *15,000* |
| **Mjete monetare nga aktivitet e shfrytezimit** | | **(11,708,625)** |
| | | |
| **Fluksi i mjeteve monetare perdorur ne aktivitetin e investimit** | | |
| *Pagesa per blerjen e aktiveve afatgjata materiale* | 8 | *(1,493,121)* |
| **Mjete monetare neto perdorur ne aktivitetin e investimit** | | **(1,493,121)** |
| | | |
| **Fluksi i mjeteve monetare nga/(perdorur ne) aktivitetin e financimit** | | |
| *Arketime nga emetimi i kapitalit aksionar* | | - |
| *Hua te arketuara* | 11 | *13,315,000* |
| **Mjete monetare neto perdorur ne aktivitetin e financimit** | | **13,315,000** |
| | | |
| **Rritje/(renie) neto ne mjete monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare** | | **113,254** |
| **Mjete monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare me 20 janar 2017** | | - |
| | | |
| **Efekti i luhatjeve te kursit te kembimit te mjeteve monetare** | | **(65,413)** |
| **Mjete monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare me 31 dhjetor 2017** | | **47,841** |

Pasqyra e fluksit te mjeteve monetare duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 8 deri ne 17, te cilat jane pjese perberese e pasqyrave financiare

## PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO

| | Kapitali i nenshkruar | Primi i lidhur me kapitalin | Rezerva Rivleresimi | Rezerva Ligjore | Rezerva Statutore | Rezerva te tjera | Fitimet e Pashperndara | Fitim / Humbja e vitit | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Pozicioni financiar me 20 janar 2017** | - | - | - | - | - | - | - | - | -- |
| (Humbja) e vitit | - | - | - | - | - | - | - | (11,513,894) | **(11,513,894)** |
| | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| **Pozicioni financiar me 31 dhjetor 2017** | - | - | - | - | - | - | - | **(11,513,894)** | **(11,513,894)** |

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital neto duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 8 deri ne 17, te cilat jane pjese perberese e pasqyrave financiare

## 1. INFORMACION I PERGJITHSHEM MBI SHOQERINE

Aquatiq shpk (ne vijimesi referuar si "Shoqeria"), eshte regjstruar me 20 janar 2017 prane Qendres Kombetare te Biznesit. Veprimtaria e Shoqerise rregullohet sipas dispozitave perkatese te ligjit "Per Shoqerite tregtare" dhe nga statuti i saj.

Aquatiq eshte nje shoqeri shqiptare e zoteruar teresisht nga Endlers Kertusha, i cili eshte edhe administratori i Shoqerise.

Selia e Shoqerise ndodhet ne Tirane, Njesia Bashkiake nr.2, Rruga e Elbasanit, Pallati nr.1 poshte Fakultetit Gjeologji - Miniera, Hyrja nr.7, Kati nr.2. me NIPT L71320011G. Shoqeria ka edhe nje adrese dytesore prane, Rruga Sheh Ahmet Pazari, Pallati Ambasador 3, kati 4, Ap.Nr.30, Tirane.

Aktiviteti kryesor i kesaj Shoqerie eshte akuaponia, nje sistem qe kombinon akuakulturen konvencionale (rritjen e kafsheve ujore te tilla si kermij, peshq, karavidhe ose karkaleca deti ne rezervuare) me hydroponine (kultivimin e bimeve ne uje) ne nje mjedis simbiotik.

Me 31 dhjetor 2017 Shoqeria ka deklaruar vetem administratorin ne listepagesen e saj.

## 2. BAZAT E PERGATITJES

### 2.1 Deklarata e pajtueshmerise

Pasqyrat financiare jane pergatitur ne perputhje me Standardet Kombetare te Kontabilitetit te Permiresuara (SKK) dhe Ligjin nr.9228, date 29 prill 2004 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

### 2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne koston historike.

### 2.3 Biznesi ne vijimesi

Pasqyrat Financiare te Shoqerise pergatiten mbi supozimin e biznesit ne vijimesi, i cili merr parasysh se Shoqeria do te vazhdoje ekzistencen e aktivitetit te saj per nje te ardhme te parashikuar.

### 2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Keto pasqyra financiare jane prezantuar ne Lek, e cila eshte edhe monedha funksionale e Shoqerise.

### 2.5 Vleresime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kerkon qe menaxhimi i shoqerise te kryeje vlersime dhe supozime qe ndikojne shumat e raportuara te aktiveve, detyrimeve te kushtezuara ne daten e pasqyres se pozicionit financiar, si dhe te ardhurave dhe shpenzimeve te krijuara ne periudhen kontabel.
Pergatitja e pasqyrave financiare kerkon nga drejtuesit te ushtrojne gjykimin e tyre ne procesin e zbatimit te politikave kontabel te shoqerise dhe shumave te raportuara te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund te ndryshoje nga keto vleresime.
Vleresimet dhe gjykimet rishikohen ne menyre te vazhdueshme dhe bazohen ne eksperiencen e meparshme dhe faktore te tjere duke perfshire pritshmerine per ngjarjet e ardhshme te cilat besohen te jene te arsyeshme ne rrethanat aktuale. Manaxhimi kryen vleresime dhe gjykime ne lidhje me te ardhmen. Vleresimet kontabel qe rezultojne sipas perkufizimit, jo gjithmone do te barazohen me rezultatet aktuale.

## 2. BAZAT E PERGATITJES SE PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

### 2.5 Vleresime dhe gjykime (vazhdim)

Vleresimet dhe supozimet qe kane risk te rendesishem per te shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, te vlerave te mbartura te aktiveve dhe detyrimeve jane pershkruar me poshte:

#### 2.5.1 Zhvleresimi i te drejtave te arketueshme

Zhvleresimi i te drejtave te arketueshme bazohet ne humbjet e vleresuara te cilat rezultojne nga pamundesia per te paguar detyrimet. Keto vleresime bazohen ne moshen e te drejtave te arketueshme dhe eksperiencen e meparshme ne cregjistrimin, vleresimin e aftesise paguese te klienteve, si dhe ndryshimet e fundit dhe te pritshme te termave te pageses. Manaxhimi vlereson ne fund te cdo periudhe ne rast se ka nevoje per zhvleresim te tyre.

#### 2.5.2 Provizionet

Provizionet ne pergjithesi kerkojne nje nivel te larte gjykimi, vecanerisht ne rastet e ceshtjeve gjyqesore. Shoqeria vlereson mundesine e krijimit te detyrimit aktual si rrjedhoje e nje ngjarje te shkuar, ne rast se mundesia e ndodhjes vleresohet te jete me shume se 50%. Ne te tilla raste shoqeria provizionon vleren e detyrimit e cila mund te matet me besueshmeri. Per shkak te nivelit te larte te pasigurise, ne disa raste mund te ndodhe qe vleresimi mund te mos jete ne te njejten linje me rezultatin e ceshtjes. Manaxhimi vlereson ne fund te cdo periudhe ne rast se ka nevoje per krijimin e provizioneve.

## 3 POLITIKAT KONTABEL

Politikat kontabel te meposhtme jane aplikuar ne menyre konsistente ne te gjitha periudhat e paraqitura ne pasqyrat financiare.

### 3.1 Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale dhe regjistrohen me kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj ne daten e raportimit konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e bilancit. Fitimi ose humbja nga kembimi ne zera monetare eshte diferenca qe vjen nga kembimi i nje numri te caktuar njesish te nje monedhe te huaj ne monedhen funksionale me kurse te ndryshme kembimi ne datat e kembimit. Te drejtat dhe detyrimet jo-monetare ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates se kryerjes se transaksionit ndersa ato qe maten me vlere te drejte rikembehen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates kur eshte percaktuar vlera e drejte. Diferencat qe rezultojne nga kursi i kembimit kalojne ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.
Kursi i kembimit i monedhave te huaja me 31 dhjetor 2017 eshte detajuar si me poshte:

| **Kurset e kembimit** | **31 dhjetor 2017** |
|---|---|
| 1 EUR | 132.95 |
| 1 USD | 111.10 |

## 3. POLITIKAT KONTABEL (VAZHDIM)

### 3.2 Instrumenta financiare

Instrumentat financiare perbehen nga mjetet monetare, nje instrument borxhi (si llogari, deftese ose hua e arketueshme ose e pagueshme) qe plotesojne kushtet, hua te marra ose te dhena dhe detyrime financiare. Instrumentat financiare njihen fillimisht me kosto plus cdo kosto transaksioni qe lidhet me to. Kostoja eshte (a) vlera e drejte e parase ose e ekuivalenteve te saj te paguara ose vlera e drejte e shperblimeve te dhena per te blere nje aktiv ne kohen e blerjes ose te ndertimit te tij (b) shuma e parase ose e ekuivalenteve te saj te arketuara ose vlera e drejte e shperblimeve te marra per te shitur nje detyrim ne kohen e shitjes ose likuidimit te tij.
Nje instrument financiar njihet nese shoqeria behet pjese e kushteve kontraktuale te instrumentit. Aktivet financiare cregjistrohen kur skadojne te drejtat kontraktuale te shoqerise mbi flukset e parase se aktivit financiar ose kur shoqeria transferon aktivin financiar tek nje pale e trete pa mbajtur kontrollin ose gjithe risqet dhe perfitimet thelbesore te aktivit. Blerjet dhe shitjet normale te aktiveve financiare kontabilizohen ne daten e transaksionit, qe eshte data ne te cilen njesia ekonomike angazhohet te bleje apo te shese aktivin. Detyrimet financiare cregjistrohen nese detyrimet kontraktuale te shoqerise skadojne, shfuqizohen ose anullohen.

*Aktivet monetare*

Aktivet monetare perfshijne arken, llogarite rrjedhese dhe depozitat ne banke. Per qellimin e pasqyres se fluksit te parase, aktivet monetare perfshijne depozita me afat me nje maturim prej tre muajsh ose me pak qe nga data e fillimit.

*Te drejtat e arketueshme*

Te drejtat e arketueshme njihen fillimisht me vleren e drejte dhe me pas me kosto te amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvleresimi. Provigjioni per zhvleresimin e aktiveve te arketueshme llogaritet kur ka te dhena se shoqeria nuk do te jete ne gjendje te mbledhe te gjitha detyrimet. Veshtiresite financiare te debitorit, mundesia qe debitori te falimentoje ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues qe te drejtat e arketueshme te zhvleresohen. Shuma e provizionit llogaritet si diference midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parase te skontuara me normen e interesit efektiv.

*Llogari te pagueshme*

Llogarite e pagueshme paraqiten me kosto dhe me pas me kosto te amortizuar, duke perdorur metoden e interesit efektiv.

*Tituj te huadhenies dhe huamarrjes*

Tituj te huadhenies dhe huamarrjes njihen me kosto minus zhvleresim, pa perfshire koston e transaksioneve. Humbja nga zhvleresimi eshte diferenca mes vleres kontabel te aktivit dhe vleresimit me te mire qe njesia mund te marre per aktivin nese ai do te shitej ne daten e raportimit. Interesat e njohura ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve jane perllogaritur mbi bazen e interesit nominal.

### 3.3 Inventaret

Inventaret njihet fillimisht me kosto historike dhe ne vijim vleresohet me vleren me te vogel mes kostos dhe cmimit te realizuar te shitjes i zvogeluar me shpenzimet e ndryshueshme te shitjes. Kostoja e inventarit perfshin koston e te gjitha materialeve te lidhura drejtperdrejt me prodhimin dhe koston e shnderrimit te ketyre materialeve ne produkte perfundimtare. Kur inventaret konsumohen, vlera e tyre e mbetur njihet si shpenzim ne periudhen ne te cilen e ardhura perkatese njihet. Shuma e renies ne vlere te invetareve deri ne cmimin e realizuar te shitjes si dhe te gjitha humbjet nga inventaret njihen si shpenzime ne periudhen ne te cilen renia ne vlere apo humbja ndodh.

## 3. POLITIKAT KONTABEL (VAZHDIM)

### 3.4 Aktive afatgjata material

*i. Njohja dhe matja*

Te gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvleresimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja perfshin shpenzime te cilat lidhen drejtperdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve te vete-ndertuara perfshin koston e materialeve dhe punes direkte, cdo kosto tjeter te lidhur drejtperdrejt me sjelljen e aktivit ne gjendje pune per qellimin e synuar te perdorimit, si dhe kosto cmontimit, heqjes se pjeseve dhe sjelljes ne gjendjen e meparshme te vendodhjes se aktivit. Shpenzimet kapitale te aktiveve te bera gjate ndertimit kapitalizohen ne "Ndertim ne proces" dhe transferohen ne kategorine perkatese te aktivit kur perfundon ndertimi i tij, nga kur aplikohet amortizimi perkates sipas kategorise. Ne rastet kur pjese te nje aktivi afatgjate material kane jetegjatesi te ndryshme, ato kontabilizohen si zera te ndryshem (komponentet me te medhenj) te aktiveve afatgjata materiale.
Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashte perdorimit percaktohen duke krahasuar vleren e shitjes me vleren e mbetur dhe keto perfshihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

*ii. Kostot e mepasshme*

Kostoja e zevendesimit te nje pjese te nje zeri te aktiveve afatgjata materiale njihet ne vleren kontabel te atij zeri nese eshte e mundshme qe shoqeria do te realizoje perfitime te ardhshme ekonomike nga perdorimi i pjeses zevendesuese dhe kostoja e pjeses mund te matet ne menyre te besueshme. Kostot e sherbimeve te zakonshme te aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

*iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke perdorur metoden e vleres se mbetur te amortizimit mbi jeten e vleresuar te cdo pjese te aktivit afatgjate material duke filluar nga dita e pare e muajit qe pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marre per baze periudhen me te shkurter midis periudhes se qirase dhe jetes se dobishme te aktivit.
Jetegjatesia e vleresuar per vitin aktual eshte si me poshte:

| **Kategoria e aktiveve** | **Metoda e Amortizimit** | **Norma e Amortizimit** |
|---|---|---|
| Toka | Nuk amortizohet | - |
| Ndertesa | Vlera e mbetur | 5% |
| Makineri e Pajisje | Vlere e mbetur | 20% |
| Pajisje Zyre | Vlere e mbetur | 20% |
| Pajisje Kompjuterike | Vlere e mbetur | 25% |
| Instrumenta dhe Vegla Pune | Vlere e mbetur | 20% |

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen ne cdo date raportimi.

*iv.* Nje ze i aktiveve afatgjata materiale cregjistrohet kur ai nxirret jashte perdorimit apo atehere kur nuk priten me perfitime ekonomike te ardhshme nga perdorimi apo nxjerrja jashte perdorimit. Fitimi dhe humbjet ne rastin e nxjerrjes jashte perdorimit te aktiveve afatgjata materiale, percaktohen sipas shumes se tyre te mbetur dhe merren paraysh ne nxjerrjen e rezultatit operativ te vitit.

## 3. POLITIKAT KONTABEL (VAZHDIM)

### 3.5 Te ardhurat

Te ardhurat njihen atehere kur eshte e mundshme qe njesia ekonomike te kete perfitime ekonomike ne te ardhmen dhe keto perfitime mund te maten me besueshmeri. Te ardhurat maten me vleren e drejte te shumes se arketuar ose te arketueshme dhe se ne vleresimin e vleres se drejte merren ne konsiderate edhe zbritjet e mundshme qe i behen cmimit te transaksionit

### 3.6 Te ardhurat e tjera te shfrytezimit

Te ardhura te tjera te shfrytezimit perftohen jashte rrjedhes normale te veprimtarise ekonomike, duke perfshire fitimet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatgjata jomateriale ndryshimet ne llogarite/kerkesat e arketueshme dhe detyrimet per t'u paguar furnitoreve (nese rezulton nje humbje neto, ajo njihet ne zerin "Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit").

### 3.7 Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat financiare perfshijne te ardhura interesi nga llogarite bankare dhe fitime nga kursi i kembimit qe njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Te ardhurat nga interesi njihen mbi bazen e te drejtave te konstatuara duke perdorur metoden e interesit efektiv.
Shpenzimet financiare perfshijne shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i kembimit, ndryshimet ne vleren e drejte te aktiveve financiare te mbajtura me vlere te drejte nepermjet llogarise fitim/humbje dhe humbjet nga zhvleresimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve me metoden e interesit efektiv.
Fitimet dhe humbjet nga kurset e kembimit raportohen ne baze neto.

### 3.8 Shpenzime te personelit

*Kontributet e detyrueshme per sigurimet shoqerore*

Njesia ekonomike paguan vetem kontributet per sigurimet shoqerore te detyrueshme qe percaktojne perfitimet e punonjesve qe dalin ne pension. Autoritetet Fiskale jane pergjegjese per percaktimin e limitit ligjor te vendosur per pensionet ne Shqiperi sipas nje plani kontributesh pensioni te percaktuar. Kontributet e Shoqerise ndaj planit te pensioneve ngarkohen ne fitim ose humbje kur ato ndodhin.
Shoqeria ka deklaruar, perllogaritur dhe paguar kontribute te sigurimeve shoqerore dhe shendetsore ne perputhje me Ligjin nr. 9136, date 11.09.2003 "Per mbledhjen e detyrueshme te kontributeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetsore", si dhe Udhezimit perkates nr. 26, date 16.04.2009.

### 3.9 Shpenzime te personelit

*Kontributet e detyrueshme per sigurimet shoqerore*

Njesia ekonomike paguan vetem kontributet per sigurimet shoqerore te detyrueshme qe percaktojne perfitimet e punonjesve qe dalin ne pension. Autoritetet Fiskale jane pergjegjese per percaktimin e limitit ligjor te vendosur per pensionet ne Shqiperi sipas nje plani kontributesh pensioni te percaktuar. Kontributet e Shoqerise ndaj planit te pensioneve ngarkohen ne fitim ose humbje kur ato ndodhin.
Shoqeria ka deklaruar, perllogaritur dhe paguar kontribute te sigurimeve shoqerore dhe shendetsore ne perputhje me Ligjin nr. 9136, date 11.09.2003 "Per mbledhjen e detyrueshme te kontributeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetsore", si dhe Udhezimit perkates nr. 26, date 16.04.2009, mesatarisht per 1 punonjes gjate vitit 2017.

## 3. POLITIKAT KONTABEL (VAZHDIM)

### 3.10 Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin perfshin tatimin e vitit, i cili njihet drejtperdrejte ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Tatimi i vitit eshte tatimi i pritshem per t'u paguar mbi te ardhurat e tatueshme te vitit, duke perdorur normat tatimore te miratuara gjate vitit.
Tatimi mbi fitimin llogaritet duke u bazuar ne ligjin ne fuqi per "Tatimin mbi fitimin". Shpenzimi i tatimit mbi fitimin perfshin te gjithe barren per vitin korrent. Norma e tatimit mbi fitimin per vitin financiar 2017 eshte 15 % (2016: 15%).

### 3.11 Transaksionet me palet e lidhur

Palet e lidhura percaktohen kur nje pale kontrollohet nga pala tjeter ose ka ndikim te rendesishem ne vendimet e biznesit apo vendimet financiare te pales tjeter. Per qellime te pasqyrave finaciare, drejtimi i shoqerise dhe manaxhimi konsiderohen si pale te lidhura.

### 3.12 Provizionet

Nje provizion njihet nese, si rezultat i nje ngjarjeje te shkuar Shoqeria ka nje detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund te vleresohet ne menyre te besueshme dhe do te kerkoje ne te ardhmen flukse dalese parash per shlyerjen e tij. Provizionet percaktohen duke skontuar flukset e pritshme te ardhshme te parase me nje norme skontimi para tatimit qe pasqyron vleresimet aktuale te tregut per vleren ne kohe te parase dhe per risqet qe lidhen me detyrimet ne fjale. Provizionet rishikohen ne cdo date raportimi dhe nese nuk ka me gjasa per daljen e ndonje fluksi parash per shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

### 3.13 Aktivet dhe detyrimet e kushtezuara

Detyrimet e kushtezuara nuk njihen ne pasqyrat financiare. Ato paraqiten ne shenime te pasqyrave financiare per aq kohe qe mundesia per nje dalje te burimeve qe perfshijne perfitime ekonomike eshte e larget. Nje aktiv i kushtezuar nuk paraqitet ne pasqyrat financiare, por paraqitet ne shenime per sa kohe ekziston mundesia e hyrjes se perfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve te kushtezuara njihet si provizion, nese eshte e mundshme qe ngjarjet e ardhshme te konfirmojne qe nje detyrim ka lindur ne daten e pozicionit financiar dhe mund te behet nje vleresim i arsyeshem i shumes.

## 4. Aktivet monetare

Aktivet monetare me 31 dhjetor 2017 perbehen si me poshte:

| *Banka* | 31 dhjetor 2017 |
|---|---|
| Banka ne monedhen e huaj (EUR) | 43,983 |
| Banka ne monedhen vendase | 3,859 |
| **Totali** | **47,841** |

## 5. Te drejta te arketueshme nga njesite ekonomike brenda grupit

Te drejta te arketueshme nga ortaku me 31 dhjetor 2017 perbehen si me poshte:

| | 31 dhjetor 2017 |
|---|---|
| Te drejta te arketueshme nga ortaku (ne valute, EUR) | 4,280,024 |
| Te drejta te arketueshme nga ortakut ne monedhen vendase | 52,771 |
| **Totali** | **4,332,795** |

## 6. Te tjera

Te drejta te arketueshme me 31 dhjetor 2017 perbehen si me poshte:

| | 31 dhjetor 2017 |
|---|---|
| TVSH e kreditueshme | 731,653 |
| **Totali** | **731,653** |

## 7. Shpenzime te shtyra

Shpenzime te shtyra me 31 dhjetor 2017 perbehen si me poshte:

| | 31 dhjetor 2017 |
|---|---|
| Shpenzime te periudhave te ardhme | 2,250 |
| **Totali** | **2,250** |

## 8. Aktive afatgjata materiale

Aktivet afatgjata materiale me 31 dhjetor 2017 perbehen si me poshte:

| Pershkrimi | Impiante dhe makineri | Te tjera instalime dhe pajisje | Totali |
|---|---|---|---|
| **Kosto** | | | |
| Pozicioni me 20 janar 2017 | - | - | - |
| Shtesa | 791,611 | 701,510 | **1,493,121** |
| Pakesime | - | - | - |
| **Pozicioni me 31 dhjetor 2017** | **791,611** | **701,510** | **1,493,121** |
| **Amortizimi i akumuluar** | - | - | - |
| Pozicioni me 20 janar 2017 | - | - | - |
| Amortizimi per 2017 | - | - | - |
| Pakesimet | - | - | - |
| **Pozicioni me 31 dhjetor 2017** | - | - | - |
| **AMM Neto 20 janar 2017** | - | - | - |
| **AMM Neto 31 dhjetor 2017** | **791,611** | **701,510** | **1,493,121** |

## 9. Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit

Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit me 31 dhjetor 2017 perbehen si me poshte:

| | 31 dhjetor 2017 |
|---|---|
| Creatics | 3,449,610 |
| Deloitte Albania shpk | 845,562 |
| Dritan Husabelliu | 302,640 |
| Deloitte Legal shpk | 159,541 |
| Vodafone sh.a | 24,573 |
| Alba Elettrica | 2,933 |
| **Totali** | **4,784,858** |

## 10. Provizione

Provizionet afatshkurtra me 31 dhjetor 2017 perbehen si me poshte:

| | 31 dhjetor 2017 |
|---|---|
| Provizione afatshkurter (gjobe per ndryshimin e adreses sekondare me vonese ne QKB) | 15,000 |
| **Totali** | **15,000** |

## 11. Titujt e huamarrjes

Titujt e huamarrjes deri me 31 dhjetor 2017 perbehen si me poshte:

| | 31 dhjetor 2017 |
|---|---|
| Hua ndaj Isa Kertusha ne valute (EUR) | 6,647,500 |
| Hua ndaj G.P.G Company shpk) ne valute (EUR) | 6,647,500 |
| Hua ndaj Isa Kertusha (ne monedhen lokale) | 20,000 |
| **Totali** | **13,315,000** |

## 12. Shpenzime te tjera nga veprimtaria e shfrytezimit

Shpenzime te tjera nga veprimtaria e shfrytezimit per periudhen nga data e themelimit te Shoqerise me 20 janar 2017 deri me 31 dhjetor 2017 perbehen si me poshte:

| | Nga data e themelimit 20 janar 2017 deri me 31 dhjetor 2017 |
|---|---|
| Studim marketingu per hyrje ne treg | 5,252,121 |
| Transport per personelin (bileta avioni) | 2,261,793 |
| Konsulence manaxheriale | 670,068 |
| Studime fizibiliteti | 601,605 |
| Sherbime ligjore | 536,092 |
| Sherbime kontabiliteti | 441,705 |
| Sherbime sekretariati | 362,846 |
| Studime mjedisore | 334,025 |
| Penalitet per pagesa te vonuara ndaj furnitoreve | 251,834 |
| Shpenzime akomodimi | 200,640 |
| Shpenzime telefonie | 178,992 |
| Taksa dhe tarifa vendore | 101,000 |
| Shpenzime dizenjo dhe interiori per zyren | 100,000 |
| Blerje te tjera te pastokueshme per zyren | 66,378 |
| Shpenzime per sherbimet bankare | 40,714 |
| Shpenzime kancelarike | 36,627 |
| Shpenzime te tjera te panjohura | 32,395 |
| Gjoba dhe demshperblime | 25,088 |
| Shpenzime web | 11,251 |
| **Totali** | **11,505,176** |

## 13. Te ardhura te tjera financiare

Te ardhura te tjera financiare per periudhen nga data e themelimit te Shoqerise me 20 janar 2017 deri me 31 dhjetor 2017 perbehen si me poshte:

| | **Nga data e themelimit 20 janar 2017 deri me 31 dhjetor 2017** |
|---|---|
| Humbje nga kembimet dhe perkthimet valutore | 126,796 |
| Fitim nga kembimet valutore | (192,208) |
| Te ardhura nga interesat | (101) |
| **Totali** | **(65,413)** |

## 14. Shpenzime te tatimit mbi fitimin

Shpenzime te tatimit mbi fitimin per periudhen nga data e themelimit te Shoqerise me 20 janar 2017 deri me 31 dhjetor 2017 perbehen si me poshte:

| | **Nga data e themelimit 20 janar 2017 deri me 31 dhjetor 2017** |
|---|---|
| Humbje para tatimit | (11,513,894) |
| Shpenzime te panjohura | 2,771,750 |
| **Fitimi/(humbja) i tatueshem i vitit** | **(8,742,144)** |
| **Humbje fiskale e mbartur** | - |
| Fitimi i tatueshem i periudhes | (8,742,144) |
| Shpenzim tatim fitimi (15% per 2017) | - |
| Tatim fitimi i parapaguar | - |
| **Tatim fitimi per tu paguar\brenda 3 prill 2018** | - |

Sipas legjislacionit fiskal shqiptar, norma e aplikueshme e tatim fitimit per vitin 2017 eshte 15%.

## 15. Ngjarje pas dates se raportimit

Nuk kane ndodhur ngjarje te tjera te metejshme pas dates se raportimit qe te kerkojne ndryshime apo rregullime te metejshme te pasqyrave financiare.

* * * * *